



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 602/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkatësi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) paraqitur kundër komisionereve të subjekteve politike, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Koalicioni Aleanca për Kosovën e Re (AKR), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 15.12.2010, mori:

VENDIM

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga LVV paraqitur përkundrejt komisionereve të LDD-se dhe LDK-se, respektivisht Rizah Beqiri dhe Sabri Gashi, në të cilën pretendohet se “ në shkollën “Mustafe Venhari”, Vushtri, me date 12.12.2010 rreth orës 13:30minuta në dhomën Nr.2704B/13/D ku votohej me kusht nuk ka funksionuar llampa, ndërsa personi përgjegjës i cili ka qene i ngarkuar për funksionimin e detektorëve ka lejuar që të votojnë personat edhe pa bere verifikimin me llampa; Ramadan Orlishta (LDD) përgjegjës për librin e parregullsive nuk ka lejuar vëzhguesit të shënojnë parregullsitë; Ekrem Maloku (AAK) përgjegjës për llampen, nuk ka përdorur detektuesin në dhomën nr. 2704B/13/D; Nehat Mehmeti (AKR) përgjegjës për spërkatjen e gishtin nuk e ka përdorur llampen; Naim Jashari ka lobuar haptazi për LDK; Hysen Hyseni (PDK) rreth orës 15:30 minuta nuk e ka përdorur llampen në dhomen nr. 2704B/01R; personat përgjegjës nuk e kanë përdorur llampen në dhomen nr. 2704B/06R; në sallën nr. 2704B/10R rreth orës 16:20 të njëjtët persona kanë votuar disa here; në sallën nr. 2704B/07R rreth orës 16:33 minuta, personi përgjegjës Faton Shabani nuk ka përdorur llampen për votuesit; gjithashtu llampat nuk kanë punuar në shkollën e mesme “Lufti Musiqi”, Vushtri, në sallën 2704B/07R; parashtruesi thekson se në baze të nenit 64.1-e të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme (LPZ) përgjegjësia për këto parregullsi i takon Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)”.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove, përveç se ka siguruar numrin e telefonit të Sabri Shytit, në rolin e përgjegjës të vëzhguesve në shkollën fillore "Mustaqe Venhari", Vushtri, dhoma nr. 2704B/13/D.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si më poshtë:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 "Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie".

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

PZAP-i vlerëson se ankesa e LVV-se paraqitur përkundrejt komisionereve të PDK-se, LDK-se, AKR-se, AAK-se dhe LDD-se, është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe përdorimin e detektorëve gjatë procesit të zgjedhjeve, fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 602/2010 më datën 15.12.2010.

